



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C-2 Turqisht

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 40 seminare

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: adritik.derjaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin A1- A2 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimit në gjuhën turke.
- 2.Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave. Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Të shkruajë prezantime dhe tekste të thjeshta në gjuhën turke, duke ndërtuar fjali të qarta dhe të kuptueshme për temat e përditshme dhe ato të mësimi.
- 2.Të kuptojë dhe interpretojë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve në kontekst, përmes strategjive si hamendësimi, analiza e parashtesave/prapashtesave dhe përdorimi i fjalorit.
- 3.Të përdorë strategji të leximit kritik për të nxjerrë informacionin kryesor dhe për të bërë përmbledhje apo konkluzione nga tekste të thjeshta në gjuhën turke.
- 4.Të zgjerojë fjalorin aktiv dhe pasiv përmes përkufizimeve, përdorimit të fjalëve në fjali dhe ushtrimeve me fjalor tematik të nivelit A1–A2.